



24 mars 2015

**AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT**

**Drejtuesit e AKP-së takuan përfaqësuesit e FMN-së**



**Prishtinë** – Drejtuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit pritën në një takim një delegacion të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të kryesuar nga z. Jacques Miniane, shef i Misionit për Kosovë, që vepron në kuadër të Departamentit Evropian.

z. Avni Jashari, ushtrues detyre i zv. drejtorit menaxhues të AKP-së së bashku me bashkëpunëtorë e njoftuan z. Miniane lidhur me aktivitetet e AKP-së dhe planin e punës të AKP-së për fazat e ardhshme. Në takim u bisedua për zhvillimet lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur në mes Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Administratës Tatimore të Kosovës, zhvillimeve rreth procesit të likuidimit, buxhetit të AKP-së dhe zhvillimeve rreth ndërmarrjes Trepça.

z. Jashari njoftoi përfaqësuesit lidhur me progresin në punën e AKP-së dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet Agjencia.

Në anën tjetër, z. Miniane falemenderoj z. Jashari për pritjen dhe njoftimin për progresin dhe zhvillimet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

**FUND**



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO